Per la prima volta e stato avvicinato e filmato un UFO in Albania

Pranë Shkëmbit të Kavajës shfaqet një disk fluturues

Jashtëtoksorë në Shqipëri?

Për herë të parë filmohet një UFO

Operatori: "Kasetën me xhirimin që kam kryer jam gati t'ua jap ekspertëve për të bërë verifikimet e duhura"

Majtas objekti misterioz i filmuar nga operatori. (Foto është marrë nga sekuencat e videokasetës origjinale) Në foton tjetër operatori Fatos Rudha

TIRANE - E enjte, 6 korrik 1995, ora 20.25. Një plazh në afërsi të Shkëmbit të Kavajës. Plazhistët janë larguar tashmë nga bregu. Të vetmit njerëz prezentë janë një grup të rinjsh që po xhirojnë një videoklip për një nga këngëtarët e njohur të vendit. Ndërsa dita është në të mbaruar, operatori Fatos Rudha ngre kamerën drejt qiellit, disa sekonda vetëm re dhe asgjë tjetër. Papritur një objekt cilindrik i ndritshëm, krejt i dallueshëm shfaqet në objektivin e kameras VHS Panasonic. Kështu, i pari shqiptar ka xhiruar "vizitorët nga kozmosi". UFO-t legjendarë, por edhe të shumëdiskutuar dokumentohen edhe në Shqipëri.

I gjithë thesari i zbulimit ruhet tani në një videokasetë normale. Fatosi tregon krejt me thjeshtësi zbulimin e tij. "E kapa rastësisht - thotë - kisha ndërmend të xhiroja tjetër gjë". Në fakt, thuajse të gjitha skenat me UFO janë xhiruar krejt rastësisht. Vetë operatori nuk ngul këmbë. "Vetëm dje në fillim më shkoi mendja te UFO-t, nuk dija të jepja ndonjë shpjegim të saktë", thotë. Po atëherë përse tani je i prirur që të besosh se në këtë rast kemi të bëjmë me UFO-t? "Pas pak kohësh u transmetua në televizion një emision në të cilin u paraqitën format e ndryshme të disqeve fluturues - përgjigjet Fatosi - pikërisht mës tipeve të ndryshëm dallova edhe formën e objektit që kam filmuar në Shkëmbin e Kavajës, por përgjigjen e saktë sigurisht duhet ta thotë një ekspert".

Në shtëpinë e Fatosit në Tiranë kemi rast të shohim skenat historike. Janë gjithsej dy sekuenca prej pak sekondash. Në të parin objekti duket ndërsa bën një fluturim në formë spiraleje që sa vjen dhe e largon nga objektivi. Rishfaqet edhe një herë, por tani më "i qetë" teksa fluturon horizontalisht. Përmasat e tij ndryshojnë gjatë fluturimit, krijohet përshtypja se kemi të bëjmë me një trup në formë elipsi që rrotullohet rreth vetes. Vetëm pak sekonda, pastaj objekti enigmatik zhduket. "U mundovë t'a shoh përsëri, por më humbi nga sytë", kujton operatori. Atë natë, Fatos Rudha është kthyer në Tiranë duke mbajtur me vete kasetën e vyer. Më pas kanë nisur diskutimet mes kolegëve të RTSH, vendit ku punon Fatosi. "Askush nuk ka ditur të më japë përgjigje të saktë, do të ishte mirë që filmin ta shihte ndonjë ekspert", shprehet ai. Ekspert, por cili? Në se dikush e ndjen veten të tillë në këtë fushë do të bënte mirë të shihte kasetën e Fatosit.

Shumë vetë kanë pretenduar deri tani se kanë parë trupa të çuditshëm fluturues, por askush nuk ka mundur të dokumentojë asgjë. Në këto raste është gjithnjë e vështirë të dallosh të vërtetën nga iluzionet që lindin shpesh pas emisioneve të suksesshme. Por në rastin e Shkëmbit të Kavajës dëshmitari ka në dorë provën mbi një objekt që është vërtet enigmatik dhe që mund të konsiderohet pa frikë një UFO, e thënë më shqip një objekt fluturues i paidentifikuar.

Ishte UFO, apo s'ishte UFO? Ndoshta kaseta me objektin e çuditshëm do të ngjallë diskutime derisa për të të shprehen njerëz që janë marrë me studimin e këtij fenomeni. Sidoqoftë, e gjithë kjo histori tregon se tani Shqipërisë "guxojnë" t'i afrohen edhe jashtëtoksorët.

Fatos Baxhaku